



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPUILL
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 790 Prot

Jorgucat, 30.04.2026

PROCESVERBALI MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK DROPUILL DATË 30.04.2026

Sot ne datën 30.04.2026 ora 10.00, u mbajt mbledhja e radhes e Keshillit Bashkiak Dropull ne sallën e mbledhjeve të Keshillit Bashkiak. Mbledhja është live.

Këshilltarë të pranishëm janë: Donika Bauçi, Kostando Ksera, Aleksander Boboli, Panajot Lulo, Angjeliqi Praso, Eljona Mano, Alketa Basho, Kristaq Frango. Kristo Varsami, Kostandina Doko, Anastas Iso, Marjeta Xhumba, Mirela Koça: Kristaq Pano, Valentina Ruxho, Efthalia Beshiri.

Mungesa: Fotaq Zhonga. Pandeli Kuremeno, Maksi Qendro, Elefteria Karaxha, Zhaneta Dralo,

Kryetarja e keshillit kryesuesi i mbledhjes.

Pjesmarres nga ana e Bashkise Dropull: Kryetari i Bashkisë z. Dhimitraq Toli,

Drejtorat: Arjan Tusha, Kleopatra Karaxha, Evi Pasxo, Grigor Dushi, Jani Panajoti, Lindita Xhuba, juristi Elidon Papazisi, Pergj te zyrave Lefter Nasto, Janulla Ngjelo, Jeorgja Vasili, specialiste buxheti Babameto, specialiste sherbimeve Anthi Nika,

Kourumii domosdoshem eshte i pranishem ne salle ,mbledhja deklarohet e hapur nga kryesuesi i mbledhjes.

Kryetarja e Keshillit fillon me rendin e dites :

1. Për miratimin e rendit të ditës.
2. Për miratimin e Proces verbalit të muajit Mars .
3. Projekt-Vendim " Për miratimin e përfituesve te fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmes ekonomike per muajin Prill 2026 " .
4. Projekt-Vendim "Për dhënien e titullit"Qytetar Nderi" Kryetarit të Bashkisë Agia në Greqi, z. Antonis Gountaras " .
5. Projekt –Vendim "Per riemërtimin e shkollës 8-vjeçare Skore, nga "Pandeli Dallas" në ish shkolla tetevjeçare "Pandeli Dallas ,Qender Etnologjike Kulturore Skore " .
6. Projekt-Vendim " "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile dhe shtesave buxhetore" .
7. Projekt-Vendim "Per miratimin e planit te masave per mbrojtjen nga zjarret" .

Jeni dakort me pikat 1,2 te rendit te dites.

Ne rendin e dites heqim pikat 8,9 per arsye mungese materjali.

Miratojme procesverbalin e muajit Mars. Miratohet

Keshilltari Panajot Lulo nderhyn per ceshtjen shurjen e emrave te fshatrave ne tabelat ne Bashkine Dropull.Para 1 viti kam kerkuar t'i bejme ankese Qeverise si Keshill per prishjen e tabeles ne Kakavi dhe prape kerkoj t,i drejtohem Qeverise me ankese si keshill per shuarjen e tabelave. Kostando ,Mirela Kerkon te bejme skrese Qeverise ne si Keshill.Kane shuar gjithë tabelat ne gjuhen greke.Kostando,Boboli te bejme nje ankese .

Kryetari i Bashkise pergjigjet kam marre masat qe ne momentin e prishjes se me njoftuan qe ne fillim dhe u kapen 3 veta dhe jane ne hetim ,jane nga Arta e Vlores djem te rinj. Kostando te kishim nje informacion.Lulo sekretare e Kesh dhe kryetarjae keshillit te te therasin zyrat te raportojne.

Zyra pergjegjese te raportoj ne Keshill.Kostando kemi kerkuar disa here per masat per guide turistike dhe per problemet qe kemi ngritur ne Keshill por nuk kemi raportimet nga administrata. Kryetarja e Keshillit :

Vazhdojme me rendin e dites

3. Projekt-Vendim " Për Miratimin e listës së përfituesve dhe masës mujore të përfitimit nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët në nevojë, për muajin Prill 2026, sipas tabelave bashkangjitur "

Relaton Kleopatra ,drejtore e ndihmes Sociale .Plotesojne kushtet per te qene perfitues nga fondi mbi fondin e kushtezuar te ndihmes ekonomike Eleni Cinga nga fshati Goranxi me te ardhura te pamjaftueshme per te perballuar shpenzimet mujore .Gjithsejt fitues ne muajin Prill 84 familje me nje fond 265.988 lek megjithe fondin 6%,mbi fondin e kushtezuar te ndihmes ekonomike.

Hedhim ne vote projekt vendimin ,Votojne 16 keshilltare pro,kundra ska ,0 abstenim. **Pra miratohet**

4. Projekt-Vendim "Për dhënien e titullit"Qytetar Nderi" Kryetarit të Bashkisë Agias në Greqi, z.Antonis Gountaras".Fjalën e merr kryetari i Bashkise i cili propozon Për dhënien e titullit"Qytetar Nderi" Kryetarit të Bashkisë Agias në Greqi, z.Antonis Gountaras".

Nderhyrje nga keshilltarja Mirela Koça per procesin e dhenies se titujve te nderit nga komisioni i keshillit. Zonj. Mirela pretendon se nuk eshte lajmeruar komisioni.Pergjigjet: sekretare e keshillit Njoftimin e komisioneve e kuni bashke me njoftimin e rendit te dites dhe e kam derguar ne email keshilltareve, drejtorave te bashkise ,nenkryetarit,pergj te zyrave per tu pregatitur per daten 29.04.2026 ora 10 sipas pikave te rendit te dites,gjithashtu dhe ne fb, nderhyrje Kryetare e Keshillit Njoftimet i kemi ne email.

Kryetari i Bashkise flet per vepren , kontributin dhe mbeshtetjen e Kryetarit te Bashkise Agias qe ne vitin 2019 ndaj Bashkise Dropull. Ne vleresim te figures qe promovon vlere ne interes te komunitetit tone, per mbeshtetjen e vazhdueshme dhe kontributin e tij ndaj Bashkise Dropull ne fusha te ndryshme si psh.Veprimtari kulturore,Inisiativa bujqesore dhe mjedisore,mbeshtetje te komunitetit lokal dhe forcimin e bashkepunimit midis Bashkise Dropullit dhe Agias dhe bashkive

te tjera evropiane duke krijuar mundesi per zhvillim lokal dhe nderkufitar dhe solidaritet nepermjet projekteve evropiane.

Per biografine dhe kontributin ndaj Bashkise Dropull flet specialiste e kultures Evridhiqi.

Kryetarja : Kalojme ne votim. Votojne 14 keshilltare pro ,kundra ska 2 abstenim(Kostando dhe Mirela) **Pra miratohet.**

5. Projekt –Vendim “Per Riemërtimin e shkollës 8-vjeçare Skore, nga “Pandeli Dallas” në ish shkolla tetevjeçare “Pandeli Dallas ,Qender Etnologjike Kulturore Skore ”.Juristi Elidon Papazisi flet per kerkesen e kryesise se fshatit Skore dhe shoqates “Lindja e Virgjereshes Mari”Skore.

Emertimi i godinave ne administrim Bashkise Dropull eshte ne kopetence te Keshillit Bashkiak ne mbeshtetje te ligjit 139/2015”Per Veteqeverisjen Vendore” Keshilli bashkiak Organizoi dhe degjese Publike ne fshatin Skore ku te gjithë ishin dakort me kerkesen per emrin e ish shkolles sipas proces verbalit bashkangjitur.Ne zbatim te VKM nr.844/2024.7.Ne rastet kur numri i shtetasve qe i perkasin nje pakice kombetare eshte minimalishtmbi 20% e numrit te popullsisë,qe banon ne kete njesi te veteqeverisjes vendore, sipas te dhenave te censit te fundit te kryer,ata kane te drejte qe krahas gjuhes shqipe te kerkojne edhe vendosjen e emertimeve ne Njesine administrative,te rrugesve dhe te treguesve te tjere topografike ne gjuhen e pakices se njohur.8.Kur permbushen rrethanat sipas pikes 7, te ketij vendimi,keshilli bashkiak miraton vendosjen e emertimeve ne gjuhen e nje pakice.

Hedhim ne vote projekt vendimin .Votojne 14 pro,kundra ska,2 abstenim.**Pra miratohet**

Keshilli ne mbledhjen e dates 30.04.2026 miratoi kerkesen e kryesise dhe shoqates per vendosjen e tabelës ne ndertesën e ish shkolles Skore ne dy gjuhe ,Greke dhe Shqiptare..

Hedhim ne vote projekt vendimin .Votojne 14 pro,kundra ska,2 abstenim.**Pra miratohet.**

Kalojme ne piken 6 te rendit te dites. Projekt-Vendim “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile dhe shtesave buxhetore”.

Relaton specialiste e buxhetit zonj.Babameto per perdorimin e fondit te kushtezuar te mbrojtjes civile.

Bashkise sone kete vit i eshte çelur fondi ne masen 11.388.378 lek, prej te cilave 5.694.189 lek jane per shtetas te demtuar dhe 5.694189 jane per investime,per rehabilitimin e demeve nga permbytjet, Nentor 2025.

Gjate zbatimit te buxhetit 2026 del e domozdoshme zbatimi i vedimeve per demshperblimet te familjeve , vleresimin e demeve per subjektet e demtuara nga zjarri masiv i dates 24.07.2025 ne fshatin Kakavi, nga zjarri ne fshatin Sotire ,ne fshatin Vrisera dhe nga perbytja ne fshatin Dervician.Kerkojme nga Keshilli Bashkiak te mundesohet demshperblimi per diferencen e mbetur per shtetasit e prekur nga zjarri sipas vendimeve te miratuar nga keshilli.Per shtesat buxhetore eshte vendosur miratimi i perdorimit te fondit te

bazuar ne performance me burim financim te huaj,a)per hartimin e planit te Mbareshtimit te ekonomise pyjore Dropulli i Siperm.b)Per blerjen e fidaneve pyjore per gjelberim ne Njesine administrative Dropull i Siperm,Dropull i Poshtem.

Kryetarja e keshillit kini pyetje ,diskutime,kalojme ne votim

Kryetarja hedhim ne vote projekt vendimin Votojne 13 pro,kundra ska ,3 abstenim.Keshilltarja Valentina Ruxho nuk voton per piken d) te projekt vendimit (konflikt interesi) **Pra miratohet**

Kalojme ne piken 7 te rendit te dites. Projekt Vendim "Per miratimin e planit te masave per mbrojtjen nga zjarret".

Projekt-Vendim "Per miratimin e planit te masave per mbrojtjen nga zjarret".Relaton per planin e masave specialiste Anthi Nika dhe drejtori Jani Panajoti.

Gjate diskutimeve doli ne mbledhjen e muajit Maj te raportoje MZSH .

Kryetarja e keshillit :Hedhim ne vote projekt vendimin .Votojne 14 keshilltare pro,kundra ska ,2 abstenim. **Pra miratohet.**

Per mbledhjen e muajit Maj Raportim nga MZSH nga zyra e kultures .

Procesverbali permban 5 faqe

Sekretar i Keshillit

Urania Kuremeno



Kryetar i Keshillit

DONIKA BAUÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KESHILLI BASHKIAK

LIST PREZENCA E TAKIMIT MË DATË: 30.09.2026, ORA 10:00

1. Marjeta Xhumba
2. Anxheta Iso
3. Kristo Varsami
4. Aleksandër Boboli
5. Kostandine Doko
6. Pengujet Julo
7. Anxhela Praso
8. Kristaq Pamo
9. Ettalia Beshiri
10. Eljona Mano
11. Alketa Basho
12. Mirnela Koco
13. Kostando Ksera
14. Kristaq Frango
15. Valerdiu Ruxho
16. Donike Bano

Sekretarja e Keshillit